



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E  
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,  
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORES,  
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 1018/2 Prot.

Lezhë, më 12 / 10 /2023

PROCESVERBAL Nr. 2

“PËR

DISKUTIMIN E PRIORITETEVE ME ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE  
PËR THIRRJEN E V-STË TË PROGRAMIT RELOAD2, FINANCUAR NGA  
BASHKIA LEZHË”

Me datë **12.10.2023**, në orën 10:00, në Qendrën Kulturore të Fëmijëve, Bashkia Lezhë organizoi takimin me Organizatat e Shoqërisë Civile, në këtë takim i informuam për hapjen e Thirrjes së V-stë në kuadër të Programit Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD) e cila është e financuar nga fondet e Bashkisë Lezhë.

Njoftimin për datën e takimit si dhe prioritetet e propozuara ju dërguan me e-mail dhe publikimi në rrjetin social (facebook) të Bashkisë Lezhë, <https://www.facebook.com/lezhebashkia/> të gjitha organizatave që kanë qenë partnerë të thirrjeve të ReLOaD 2 në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, njoftimi është publikuar dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë në linkun <https://lezha.gov.al/info-day-thirrja-e-pest-e-reload/>

Pas disa konsultimesh midis stafit të bashkisë me përfaqësues nga sektorë të ndryshëm, bazuar dhe në dokumentat strategjikë afat mesëm dhe afat gjatë të Bashkisë Lezhë u përzgjedhën prioritetet të detajuara si më poshtë:

**1. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm bazuar në trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Lezhës;**

1.1: Promovimi i resurseve historike, kulturore dhe gastronomike për zhvillimin e një turizëm të qëndrueshëm;

1.2: Promovimi i jetës artistike dhe kulturore të zonave urbane dhe rurale të bashkisë Lezhë;

1.3: Organizimi i të rinjve në promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

**2. Cilësia e jetës dhe komunitetit;**

2.1: Shtimi i shanseve integruese, pasurimi dhe modernizimi i jetës së fëmijëve, të rinjve dhe grave;

2.2: Aftësimi dhe rritja e kapaciteteve të grupeve të marginalizuara për tu përshatur në tregun e punës;

2.3: Nxitja e studimeve rreth sigurisë ushqimore.

**3. Zhvillim i qëndrueshëm dhe mbrojtja e mjedisit;**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA LEZHË**

- 3.1: Edukimi dhe ndërgjegjësimi për çështjet e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit;  
3.2: Ndërgjegjësimi për ndryshimet klimatike;  
3.3: Ulja e ndotjeve në mjedis dhe rritja e mekanizmave mbrojtës për natyrën dhe biodiveristetin.

**4. Zhvillimi i aftësive kompjuterike dhe sistemeve të informatizuara (TIK);**

- 4.1: Rritja e aftësive, aksesit dhe përfshirjes digjitale të komunitetit në shoqërinë e informacionit;  
4.2: Rritjen e kapaciteteve të rinjve në fushat e Kodimit, Programimit, Dizajnit Grafik;  
4.3: Aftësim në fushën e menaxhimit të rrjeteve sociale, marketingu digjital.

Në takim mori pjesë **z. Elson Frroku**, drejtor i Drejtorisë së Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës si dhe 18 pjesëmarrës në takim. Axhenda e takimit konsistonte në një prezantim të shkurtër mbi zbatimin e Programin ReLOaD 2, informim mbi projektet e zbatuara në 4 (katër) Thirrjet e Para Publike, si dhe prezantimi prioriteteve, afatet e përafërta të shpalljes së thirrjes së pestë, shuma në dipozicion dhe kohëzgjatja e zbatimit të projekteve.

Pasi u njohën me prioritetet përfaqësuesit e OSHC-ve konkretisht:

- Afërdita Gjoni - Përfaqësuese e Marry Word Loreto, falenderoi për mundësinë që bashkia iu ofron oshc, ndër të tjera vuri theksin në qëndrueshmërinë që duhet të kenë projektet të cilat fitohen;
- Madalena Gega – Përfaqësuese e GVN, rëndësinë e delegimeve të shërbimeve pranë OSHC-ve. Pyetja e saj ishte për nevojën e rritjeve të kapaciteteve të oshc në Lezhë;

Gjithashtu, përfaqësues të OSHC, përgëzuan Bashkinë Lezhë për nismën e marrë si dhe vunë theksin që prioritet të kenë OSHC-të lokale të Lezhës, si dhe iu dha afat kohor prej 5 (pesë) ditë OSHC-ve për të dërguar rekomandime/ sugjerime për prioritetet e Thirrjes V-stë ReLOaD2.

Takimi u mbyll në orën 10:46.

**DREJTORI**  
**Elson Frroku**